



JETA E RE NË TË *Nga mbjellja e farës te rritja e frytit*

Besnikë në të mbledhurit bashkë

“Pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë tonin ...”

Para dhjetë vjetësh një burrë deklaroi se ishte shpëtuar dhe u pagëzua përpara asamblesë. Ai nuk u kthye kurrë. Kam parë besimtarë të rinj të cilët, dikur frekuentonin rregullisht çdo takim të asamblesë, por që avash-avash filluan të fiken pas një a dy vjetësh. Disa besimtarë më të vjetër kanë bërë mungesa të dukshme me kalimin e kohës për shkak të punës, çlodhjes së nevojshme, kohës familjare apo nga dëshira për të mundur turmat në restorante. A duhet të bëhet ky qëndrim një shkak për t’u shqetësuar? Sa të rëndësishme janë takimet e kishës lokale gjithsesi?

Mund të ndodhë që disa të cilët janë larguar nga takimet e kishës lokale të jenë në të vërtetë të shpëtuar (1 Gjo. 2:19). Një jobesimtar nuk ka oreks frymëror për Fjalën e Perëndisë (Rom. 8:5) apo për përbashkësi të perëndishme me besimtarët (1 Gjo. 1:7). Një ditë në të ardhmen, shumë nga ata që pohojnë se janë të shpëtuar do të demaskohen si jobesimtarë (Mat. 7:22). Por është plotësisht e mundur që besimtarët e vërtetë të kalojnë beteja në jetën e tyre të krishterë. Të ecësh i patundur në Zotin kërkon disiplinë (1 Kor. 9:27), duke shfrytëzuar burimet frymërore që janë në dispozicionin tonë (Efe. 6:10-18). Është lehtë të tërhiqesh.

Letra drejtuar Hebrenjve flet për këtë prirje dhe merret me probleme si: rrëshqitja doktrimore (2:1), mungesa e sigurisë (3:14; 10:35); përtacia frymërore (5:11-14), mundësia e rrëfimit të rremë të besimit (6:1-9), mungesa e durimit në lidhje me bartjen e gjatë (6:12; 10:36) dhe përqafimi i një feje boshe dhe jo i Shpëtimtarit të gjallë (6:1-2). Ilaçi

për këto probleme jepet qartë në faqet e fundit të librit dhe të qenit besnikë në pjesëmarrjen në takime është kryesore:

“Le të mbajmë të patundur rrëfimin e shpresës sonë, sepse besnik është ai që premtoi. Dhe le të kujdesemi për njeri tjetrin, për t’u nxitur për dashuri dhe vepra të mira, pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë tonin,

sikurse kanë zakon disa, por të nxisim njeri tjetrin, aq më tepër se e shihni ditën që po afrohet” (Heb. 10:23-25).

Sigurisht që pjesëmarrja në takime në vetvete nuk e bën dikë frymëror, megjithatë çdo takim i kishës së Dhiatës së Re kishte një qëllim për ndërtimin e besimtarit.

Nganjëherë ata u takuan për lutje (Vep. 4:31), për mësim (Vep. 11:26), për njoftime mbi punën misionare (Vep. 14:27), për thyerjen e bukës (Vep. 20:7) apo për të qenë përgjegjës ndaj njeri tjetrit (1 Kor. 5:4;

14:29, 32). Ndërsa kisha mblidhej së bashku “*në një vend*” (1 Kor. 14:23) besimtarët ndërtoheshin, nxiteshin dhe ngushëlloheshin nga Fjala e Perëndisë (1 Kor. 14:3-5, 12, 17, 26), nga të kënduarit (1 Kor. 14:15) dhe nga lutja (1 Kor. 14:16). Besimtarë frymërorë me dhunti përkatëse ishin të pranishëm për “*përsosjen [pjekjen] e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit*” (Efe. 4:11-13). Çdo besimtar ishte frymërisht i pajisur për të luajtur një rol të nevojshëm në kishën lokale (1 Kor. 12:22). Një vëlla e ka thënë mirë: “Ne kemi nevojë për ty dhe ti ke nevojë për ne” në takimet e asamblesë lokale.

